

Raporti Vjetor 2016

# YMCA NË KOSOVË

# George Williams Youth Association

The Official Representative of the  
World YMCA in Kosovo

## Mirësevini

|                                  |      |
|----------------------------------|------|
| Të dashur miq (Presidenti & CEO) | 3    |
| Rreth nesh                       | 5    |
| Njerëzit tanë                    | 6    |
| Financuesit dhe partnerët        | 7    |
| Eventet kryesore të organizatës  | 9    |
| Projektet për të rinjë           | 10   |
| Projektet për fëmijë             | 11   |
| Projektet me komunitetin         | 12   |
| Projektet ndërkombëtare          | 13   |
| Financat                         | 15   |
| Mirënjohjet dhe falënderimet     | 17   |
| Lidhu dhe kontakto me ne         | Fund |



*Pjesëmarrësit e Leadership-it gjatë një sfide*



*Tina njëra nga liderët më të rinjë nga Gjakova*

Të dashur miq,

Ne ja dolëm! Ky vit ka qenë një shembull i mirë i rritjes institucionale. Me ndihmën e partnerëve tanë nga gjithë bota dhe Kosova kemi ndërtuar një qeverisje të fuqishme me një asamble aktive, anëtarë të dedikuar të bordit, staf dhe vullnetarë të përgatitur.

Viti 2016 ka qenë viti në të cilin ne kemi miratuar procesin demokratik, transparent dhe kemi rënë dakord për strategjinë e re “Vizioni 2020” që do të udhëheqë organizatën tonë nga viti 2016 deri në 2020.

Mungesa e qendrave rinore në komuna të ndryshme, hapësirave dhe programeve përkatëse për të rinjtë që të kalojnë kohën e lirë në mënyrë konstruktive është një sfidë në vete, ne si organizatë do të vazhdojmë të flasim, të mbrojmë dhe të krijojmë hapësirë të sigurt për të rinjtë e të gjitha komuniteteve. Ne do të vazhdojmë të promovojmë pjesëmarrjen e të rinjëve, të përmirësojmë programet dhe hapësirat tona dhe përmes Ambasadorëve tanë të rinjë të sigurohemi që zëri dhe shqetësimet e të rinjëve të dëgjohen.

Ka pasur disa pika kryesore këtë vit, por arritja më e madhe ka qenë anëtarësimi me të drejta të plota në YMCA Evropa ku me krenari e përfaqësojmë Republikën e Kosovës. Gjithë kjo është arritur me punën e madhe të stafit dhe kontributin e vullnetarëve tanë të cilët ndihmuan në ndërtimin e lëvizjes me anë të së cilës ndihmojmë njerëzit dhe komunitetin çdo ditë.

Jemi krenarë që jemi pjesë e YMCA dhe po ndihmojmë të ndërtojmë diçka të madhe që do të i shërbejë të gjitha komuniteteve në Kosovë.


Fuqizimi i Rinisë është rrahja e zemrës për lëvizjen tonë!

Dorina Lluka Davies, CEO

Besnik Leka, President



*Dorina dhe Besniku duke i dhuruar raportin One Million Voices Z. Arban Abrashi i cili është Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale*



*Ambasadorja jonë e re Drenusha me ambasadorin Britanik në Kosovë Z. Ruairi O'Connell*

# Rreth nesh

## Misioni ynë

*Të jemi një lëvizje gjithëpërfshirëse ku njerëzit rriten në mendje, trup dhe shpirt.*

## Vizioni ynë

*Të jemi një lëvizje e fortë dhe e besueshme në të cilën njerëzit mund të rriten në mendje, trup dhe shpirt.*

*Të ndërtojmë liderë të së ardhmes dhe së tashmes dhe të investojmë në të rinjtë.*

*Të promovojmë paqe, unitet dhe të respektojmë dallimet dhe diversitetin e secilit.*



*Pjesëmarrësit e Y WoMan para sfidës në komunitet.*

# Njerëzit tanë

## Anëtarët e bordit

Besnik Leka  
Dominik Demaj  
Milot Ferizi  
Zana Jaha  
Rinor Hasi

President  
Arkatar  
Anëtar i bordit  
Anëtar i bordit  
Anëtar i bordit

## Stafi

Dorina Davies  
Adhurim Bekaj  
Erina Arllati  
Qendrim Parashumti  
Flori Llluka  
Valbone Kabashi  
Adi Davies  
Dorina Glllogjani  
Qendrim Llluka  
Nita Gjoshi  
Dren Haxija  
Fëllanza Tarku  
Laura Qarkakhija  
Errisa Haximja  
Jeta Tetrica

Drejtoreshë  
Zyrtar i financave  
Punëtore e financave  
Koordinator i dyqanit  
Punëtore e dyqanit  
Punëtore e dyqanit  
Koordinator i rinisë  
Punëtor rinor  
Punëtor rinor  
Punëtor rinor  
Punëtor rinor  
Punëtor rinor  
Koordinatore për fëmijë/ Punëtor rinor  
Praktikante  
Praktikante

## Vullnetarët

Anjesa Haziraj  
Avnora Morina  
Erëllinda Avdimetaj  
Glera Lusha  
Pyllion Nura  
Ardit Cana  
Era Ferizi  
Ariana Sahatqija  
Dardan Hoti

Punëtor rinor  
Punëtor rinor  
Punëtor për fëmijë  
Ten Sing  
Ten Sing  
Ekipi i të rinjve  
Ekipi i të rinjve  
Ekipi i të rinjve  
Media



## Financuesit dhe partnerët

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit  
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale  
Ministria e Edukimit, Shkencës dhe Teknologjisë  
YMCA Bota  
YMCA Evropa  
Y USA  
YMCA Anglia  
YMCA Finlanda  
KCSF – Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile  
Y's Men Internacional  
Y's Men Rajoni I Danimakës  
Y's Men Clubi Hardernes  
Holstenbro Nedhjaelp  
UNDP – Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara  
YMCA World Service  
YMCA Fairthorne Group  
D4D – Demokracia për Zhvillim  
Ambasada Britanike në Kosovë  
Bethany Christian Service in Kosovo  
Action for Mother's and Children -AMC



## Komunat në të cilat ne punojmë

Prishtina  
Fushë Kosova  
Gjakova  
Peja  
Juniku





*Lumi një nga udhëheqësit rinor nga Peja*

## Eventet kryesore të organizatës

Si organizatë kemi arritur shumë gjëra gjatë vitit 2016, disa pika kulminante ishin mundësi që për ne vijjnë një herë në jetë, i tillë ka qenë fjalimi i Drejtoreshës tonë Dorines në Kombet e Bashkuara në New York dhe falënderimi për punën që organizata jonë po bënë nga Lartmadhëria e tij Princi Charles gjatë vizitës së tij në Kosovë.



Gjatë kohës që ne ishim në këto evente organizata jonë ka përparuar edhe në fusha të tjera. Anëtarësimi me të drejta të plota në YMCA Evropa është një hap përpara për ne në aspektin e integritit ndërkombëtar, ndërsa në fund të vitit 2016 jemi akredituar për dërgimin dhe pranimin e pjesëmarrësve EVS (Shërbimi Vullnetar Evropian).



Gjithashtu në vitin 2016 kemi filluar partneritet me një tjetër komunë, atë të Junikut. Partneriteti i fuqishëm me këtë komunë na ka dhënë mundësinë që të hapim një zyre të re në Kullën e qytetit ku filluam me programin e Leadership-it për komunitetin në të cilin u angazhuan mbi 50 të rinjë.

# Programet për të rinjtë



## Programet e rëndësishme kombëtare

Në vitin 2016 kemi vazhduar me programet tona kryesore në Gjakovë, Fushë Kosovë dhe Pejë. Në muajin tetor kemi filluar me trajnimet për Leadership në Junik i cili po zhvillohet shumë mirë. Ten Sing i cili është program për arte performuese ka qenë i identifikuar si program i rëndësishëm për ne dhe pjesë e strategjisë Vizioni 2020, Gjakova udhëheq me këtë program dhe ka pasur 6 grupe të Ten Sing këtë vit.

### Aktiviteti kryesor i vitit për të rinjtë

Këtë vit kemi nisur programin kombëtar Ambasadorët e rinjë, i cili është program për liderët e rinjë që kanë prezantuar organizatën ndërkombëtarisht. Roli i tyre tani është të ndihmojnë organizatën në kuptimin e vizibilitetit, rritjes së fondeve, projekteve dhe avokimit. Janë 20 ambasadorë nga katër qytete dhe ata në muajin tetor qëndruan bashkë një vikend për të u njoftuar me programin.



### Y CAFE

Është një iniciativë e re që zhvillohet në Qendën Rinore në Pejë. Pas bisedave me të rinjtë ne si organizatë kuptuam që të rinjtë kanë nevojë për më shumë hapësirë dhe kohë të lirë vetëm për tu relaksuar. Kemi filluar sesionin një pasdite të së shtunës dhe vazhdimisht shtuam aktivitete, të tilla si Monopol, Jenga, Banane me çokollatë dhe punëdore me letra (origami).

### Kampi verorë në Greqi

Përsëri organizata jonë dërgoi 20 pjesëmarrës në kampin e Greqisë në Selanik për një javë të mbushur me aktivitete, shoqëri dhe me kujtime që do të ju mbesin në mend gjithë jetën. Këtë vit kishim pjesëmarrës nga Peja dhe Gjakova.

### Statistikat

|                                     |     |
|-------------------------------------|-----|
| Të rinjë të përfshirë               | 645 |
| Meshkuj                             | 264 |
| Femra                               | 374 |
| 5 programe të rëndësishme kombëtare |     |
| Pjesëmarrës nga 5 qytete            |     |



# Programet për fëmijë



## Fusion

Gjatë gjysmës së parë të vitit pas bisedimeve me komunën e Gjakovës ne hapëm grupin për të rinjtë nga moshë 10-14 vjeç. Të cilët ishin të rritur për kampet tona të fundjavës dhe shumë të vegjël për programet e të rinjve. Të gjithë këta pjesmarrës tashmë kanë kaluar në programet tona për të rinjtë.

## Aktivitet kryesore të fëmijëve 2016

Në muajin shtator janë bërë bashkë një koordinator dhe një ekip për të udhëhequr programet për fëmijë në bazë të një strukture të re. Ne vendosëm të rikthejmë programin After-School duke e udhëhequr atë çdo të shtunë në qendrën tonë në Gjakovë. Numri i pjesmarrësve ka filluar të rritet dhe programi ka marrë reputacion të mirë në qytet.



## Kampi veror dhe dimëror

Këtë vit gjatë pushimeve verore dhe dimërore kemi punuar me kampe të fëmijëve, të moshave prej 7-13 vjeç. Ky kamp ka përfshirë shumë aktivitete, lojra, punëdore, ushqim dhe pije. Secili fëmijë ka marrë certifikatën e pjesëmarrjes, është vizituar dhe ka marrë dhuratë nga babagjyshi.

## Kampi shkollor i fëmijëve

Në fillim të vitit kemi vazhduam me Kampet e fundjavës me fëmijët në shkolla. Me këtë aktivitet kemi hasur shumë vështirësi në komunikim dhe me orarin e hapjes së shkollave.

Në fillim të vitit ky projekt është ndaluar por shpresojmë që do të rikthehet së shpejti në të ardhmen.

## Statistikat

|                     |    |
|---------------------|----|
| Fëmijë të përfshirë | 81 |
| Vajza               | 45 |
| Djem                | 36 |



# Projektet për komunitetin

## Dyqani i bamirësisë



Ne kemi vendosur që të kemi nga një dyqan në çdo qytet, prandaj dyqani i dytë në qytetin e Gjakovës këtë vit është mbyllur, megjithatë janë arritur objektivat për të shitur mallrat që posedonte. Kemi filluar negociatat për të hapur dyqane të reja në komuna të tjera. Ne gjithashtu kemi punësuar një koordinator të ri për të forcuar këtë fushë. Partneriteti jonë me Danimarkën për rroba, lodra, lojra dhe sende shtëpiake vazhdon.

## Aktivitetet për komunitet

Këtë herë kemi siguruar më shumë pako ushqimesh. Katër vite më parë projekti ka filluar nga një donacion modest personal, ndërsa këtë vit kemi parë shumë familje nga disa komuna të përfitojnë nga donacionet globale. Ne kemi punuar me Bethany Christian Services në Gjakovë për të siguruar ushqim për festat e fundvitit për familjet nga pakicat etnike. Ne gjithashtu kemi bashkëpunuar me Komunën e Pejës e cila bashkoi disa OJQ për të realizuar javën e dhënies së ndihmave.



## Rroba dhe lodra për fëmijë

Organizata jonë vazhdon të kontribuojë në dhënien e rrobave, lojrave dhe arushëve prej pellushi atyre që kanë nevojë. Këtë vit për të mbështetur punën e OJQ-së Aksioni i Nënave dhe fëmijëve kemi dhuruar mbi 450 palë rroba. Rrobat, lodrat dhe lojërat kanë ardhur nga Danimarka dhe u bënë gati dhe u pastruan nga një ekip vullnetarësh të përkushtuar.



## Statistikat

|                  |     |
|------------------|-----|
| Pakot e ushqimit | 160 |
| Rroba            | 500 |
| Lodra dhe Lojëra | 250 |



# Projektet ndërkombëtare

## Aktivitetet e YMCA Botës

Këtë vit pjesëmarrësit nga Kosova ishin të përfshirë në programin Agjentët e Ndryshimit i cili pikën kulminante e kishte në Tailandë me mbledhjen e dytë botërore. Ne gjithashtu kishim të përfshirë tre pjesëmarrës në iniciativën Kampi Global në Zvicër, ku kanë mësuar metodologji të reja programore me shpresën se ata do të i zbatojnë ato në Kosovë. Drejtoresha jonë Dorina gjithashtu mori pjesë në forumin botëror NGS në Tailandë.



## Të arriturat ndërkombëtare të viti

Në muajin tetor drejtoresha jonë Dorina mori pjesë në konferencën e kampeve në Frost Valley YMCA në SHBA. Gjatë këtij event u mbajt një ankand për lëvizjen tonë dhe u mbledhën rreth 20.000\$.



## Partneritetet Erasmus +

Gjatë vitit 2016 kemi bërë partneritet me shumë YMCA ndërkombëtare, shumë më shumë se viteve të kaluara. Këtë vit kemi marrë pjesë në evente në Danimarkë, Francë, Holandë, Irlandën e Veriut dhe Norvegji.

## Rrjeti Urban Botëror

Kosova është ftuar në Rrjetin Urban Botëror në Winchester të Anglisë, i cili është një mbledhje e YMCA lokale më të mëdha në botë, këtë e kanë bërë të mundur miqtë dhe partnerët tanë nga YMCA Fairthorne.



Krahas njerëzve tanë që udhëtojnë ne gjithashtu kemi dëshirë të mirëpresim të tjerët në Kosovë. Këtë vit kemi mirëpritur njerëz nga Japonia, Danimarka, Anglia, Brazili, Finlanda dhe Irlanda Veriore që vizituan Kosovën.

## Statistikat

|                          |    |
|--------------------------|----|
| Pjesëmarrës ndërkombëtar | 51 |
| Vizitor                  | 22 |



*Ariana liderja jonë e re nga Juniku*

# Financat

## George Williams Youth Association në Kosovë - YMCA në Kosovë Deklarata e bilancit financiar për vitin 2016 (Janar - Dhjetor)

|                                                |                       |
|------------------------------------------------|-----------------------|
| Kostoja e funksionimit të programeve<br>(Euro) | 61,795.05             |
| Kostoja e menaxhimit dhe administratës         | 25,187.60             |
| <b>Totali</b>                                  | <b>86,982.65 Euro</b> |

**Nga shuma totale 13.01% e fondeve erdhën nga projektet tona që gjenerojnë të adhura.**

Të ardhurat totale janë rritur nga viti i kaluar për shkak të mbështetjes institucionale vendore dhe ndërkombëtare, këtë vit ne jemi të lumtur të raportojmë për suksesin e auditimeve të jashtme dhe të brendshme. Auditimi i jashtëm ka qenë në një nga programet tona kryesore dhe ishte një mjet i rëndësishëm mësimi për ne duke qenë se edhe sipas ligjit ne do të duhet të kemi një auditim të jashtëm për të gjithë organizatën në vitin 2017 për shkak të sasisë së të hyrave të parashikuara.

Përqindja e përgjithshme e fondeve nga projektet rigjeneruese të fondeve ka rënë nga viti i kaluar për shkak të mbylljes së dyqanit të dytë në Gjakovë dhe një rritje e të hollave nga grantet.

Jemi duke parashikuar të ardhura më të larta për vitin që vjen me planet për të hapur dyqanin e dytë në një qytet tjetër, mënyrës së re të anëtarësimit, si dhe të hyrave nga programet e të rinjve dhe fëmijëve.

Financiarisht ne ndihemi të relaksuar për shkak të kontratave të cilat janë vendosur nga viti i kaluar, ne jemi të kënaqur me drejtimin e përgjithshëm të financave dhe po vazhdojmë të punojmë në proceset dhe politikat e brendshme për të siguruar që shërbimet tona nuk do të kenë probleme.

Dominik Demaj, Drejtor i thesarit

Adhurim Bekaj, Zyrtar i financave



*Shpresa një nga lideret tona nga Fushë Kosova*

# Mirënjohtet dhe falënderimet

## Field Group

Jenni Enqvist  
Paul Smillie  
Adam Rychlik

YMCA Finlanda  
YMCA Anglia  
YMCA Europa

## Donatorët e projektit të dhënies së ndihmave

YMCA Finlanda  
YMCA Boulder Valley, SHBA  
Ken Montgomery  
Sarah dhe Nigel Booth  
Chris Bailey  
Steve dhe Rachel Dyne  
Mariko Ikeda



*Vizita e Field Grupit në Pejë gjatë kohës që ishin në Kosovë (shtator)*

## Çmimet e YMCA 2016

Volunteer of the Year  
Attendee  
Partner of the Year  
Young Volunteer  
Young Leader  
Project of the Year  
Service Award

Anjesa Haziraj  
Baton Luzha  
Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile -KCSF  
Diellza Salicana  
Don Dobruna  
Leadership Program  
Besnik Leka



## Faleminderit stafit që janë larguar këtë vit

Adelina Qarri  
Arita Zherka  
Myrvete Arllati  
Shiqiprim Hyseni  
Shipe Mula  
Martin Berisha

Zyrtare e financave  
Punëtore për fëmijë  
Punëtore e dyqanit  
Punëtor për fëmijë  
Punëtore për fëmijë  
Projektet që gjenerojnë të ardhura



*Fëmijët gjatë programit afterschool*

## Lidhuni me ne

**Facebook:** <https://www.facebook.com/YMCAinKosovo>

**Twitter:** <https://twitter.com/YMCAKosovo>

**Google Plus:** <https://plus.google.com/+YmcaKosovo/posts>

**Fliker:** <https://www.flickr.com/photos/99135595@N04>

**Blog:** <http://ymcainkosovo.blogspot.com>

**Youtube:** <https://www.youtube.com/user/YWCAYMCAinKosovo>

## Kontaktoni me ne

George William Youth Association në Kosovë,  
Rr. Ismail Qemalin.n.  
Gjakova,  
50 000,  
Republika e Kosovës

[georgewilliamsyouthassociation@gmail.com](mailto:georgewilliamsyouthassociation@gmail.com)

George Williams  
Youth Association

The Official Representative of the  
World YMCA in Kosovo